LIGJ
Nr. 73/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES ISTISNA'A DHE TË MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË AGJENCISË ISTISNA'A NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR NDËRTIMIN E SEGMENTIT QUKËS–QAFËPLLOÇË, SI PJESË E KORRIDORIT RRUGOR TIRANË–KORÇË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 128/2013

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes Istisna'a dhe marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për ndërtimin e segmentit Qukës–Qafëplloçë, si pjesë e korridorit rrugor Tiranë–Korçë, ratifikuar me ligjin nr. 128/2013, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar, më datë 17.11.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13875, datë 7.12.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Kodi i Projektit: ALB-1011

MARRËVESHJE NDRYSHUESE E MARRËVESHJES ISTISNA'A .
NR. ALB-0036/ALB-0107 DATË 2/6/1434H (12/4/2013G)

NDËRMJET

KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

FINANCIM SHTESË PËR NDËRTIMIN E SEKSIONIT QUKËS-QAFË PLLOÇË TË PROJEKTIT TË KORRIDORIT RRUGOR TIRANË-KORÇË (SHITJE ME KËSTE)

MARRËVESHJE NDRYSHUESE

MARRËVESHJE NDRYSHUESE e datës_05_/_12_/_1443_H e cila i korrespondon_04_/_07_/_2022_ G

NGA DHE NDËRMJET

KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Përfituesi)

DHE

BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (BIZH ose **Banka)**

Secila referohet si **"Palë"** dhe të dyja së bashku si **"Palët"**

DUKE PASUR PARASYSH SE

A. Përfituesi dhe Banka Islamike për Zhvillim nënshkruan Marrëveshjen Istisna'a dhe Marrëveshjen përkatëse të Agjencisë më 02/06/1434H (12/4/2013G) (në vijim të referuara si Marrëveshjet Istisna'a) për të financuar Ndërtimin ALB-0036 të seksionit Qukës-Qafë Plloçë të Projektit të Korridorit Rrugor Tiranë-Korçë, siç përcaktohet në Anekset e Marrëveshjes Istisna'a (në vijim të referuara si Asetet e Projektit Istisna'a) për një shumë prej 125,000,000 USD (Njëqind e Njëzet e Pesë Milionë Dollarë Amerikanë). Marrëveshjet Istisna'a hynë në fuqi në datën 19/11/2014G

B. Përfituesi i ka kërkuar Bankës financim shtesë për të blerë asete shtesë që i përkasin Projektit, siç përshkruhen në mënyrë specifike në Skedulin-I të kësaj Marrëveshjeje.

C. Si rrjedhojë, Banka Islamike për Zhvillim ka pranuar kërkesën e Përfituesit dhe në datën 18 dhjetor 2021G miratoi dhe dakordësoi duke u bazuar, ndër të tjera, në Marrëveshjen pararendëse, që të akordojë financim shtesë nëpërmjet mënyrës së financimit të shitjes me këste për të prokuruar Asetet e Projektit, të cilat janë krijuar nga Asetet e Projektit Istisna'a, për një vlerë që nuk kalon shumën prej 56,800,000 USD (pesëdhjetë e gjashtë milion e tetë qind mijë Dollarë Amerikanë) sipas termave dhe kushteve të përcaktuara më poshtë.

D. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të amendojë Marrëveshjet fillestare Istisna'a dhe të përcaktojë mirëkuptimin e përbashkët të Palëve në lidhje me zbatimin e Projektit.

TASHMË, SI RRJEDHOJË, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni-1 KUSHTET E PËRGJITHSHME; PËRKUFIZIME

1.1 Kushtet e Përgjithshme

1.1.1 Kjo Marrëveshje i nënshtrohet Botimit të vitit 2020 të Kushteve të Përgjithshme të BIZH-it, të Zbatueshme për Financimin me Këste (Kushtet e Përgjithshme). Klauzolat e zbatueshme të Kushteve të Përgjithshme përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.1.2 Në rastin e ndonjë mospërputhjeje ndërmjet termave të kësaj Marrëveshjeje dhe Kushteve të Përgjithshme, termat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

1.2 Përkufizime

1.2.1 Në të gjitha rastet e përdorimit në këtë Marrëveshje, termat e ndryshëm të përcaktuar në Pjesën I (**Termat e Përgjithshëm të Financimit të Projektit**) ose Pjesën II **(Termat e Përgjithshëm të Shitjes)** kanë kuptimin përkatës të përcaktuar në to, përveç rasteve kur janë ndryshuar apo kur e kërkon konteksti. Termat shtesë që janë përdorur në këtë Marrëveshje, kanë kuptimin e mëposhtëm:

Rregullimi i Diferencës së Çmimit: do të thotë diferenca e çmimit ndërmjet Normës Mesatare 10 vjeçare të Kundërkëmbimit dhe Normës Referencë të Zëvendësimit, e cila mund të jetë pozitive, negative ose zero dhe përcaktohet nga banka në të drejtën e saj të vetme me qëllim ruajtjen e ekonomisë së nënkuptuar të financimit të dhënë sipas Dokumenteve të Financimit për Përfituesin dhe Bankën, duke marrë në konsideratë (a) çdo përzgjedhje apo rekomandim për rregullimin e diferencës së çmimit apo çdo metodë për llogaritjen dhe përcaktimin e rregullimit të diferencës së çmimit për zëvendësimin e Normës mesatare 10 vjeçare të kundërkëmbimit në një moment të caktuar prej Shoqatës Ndërkombëtare të Shkëmbimeve dhe Derivateve, Inc. ose Entit Përkatës Emërues, ose (b) çdo marrëveshje tregu në zhvillim apo mbizotëruese në atë moment për llogaritjen dhe përcaktimin e rregullimit të diferencës së çmimit për zëvendësimin e Normës Mesatare 10 vjeçare të Kundërkëmbimit

Marrëveshje Agjencie: do të thotë çdo marrëveshje agjencie e ekzekutuar ndërmjet Bankës dhe Përfituesit në datën e kësaj Marrëveshje dhe në vijim sipas se cilës Banka emëron Përfituesin si përfaqësues që, ndër të tjera, merr në dorëzim Asetet e Projektit

Marrëveshje Ndryshuese: do të thotë kjo Marrëveshje për ndryshimin e Marrëveshjes Istisna'a Nr. ALB-0036 të nënshkruar më 02/06/1434H (12/4/2013G). Të gjitha referencat ndaj "Marrëveshjes Kuadër", siç përcaktohen në Kushtet e Përgjithshme dhe që përmenden në secilin prej Dokumenteve të Financimit, do të interpretohen se nënkuptojnë këtë Marrëveshje në lidhje me Normën Mesatare 10 vjeçare të Kundërkëmbimit

Rast Zëvendësimi i Normës së Referimit:

(a) do të thotë një përcaktim në mirëbesim nga Banka (përcaktimi duhet të jetë përfundimtar dhe pa gabime të dukshme) që të paktën 10 financime të përbashkëta dypalëshe ose të shpërndara me një përmbajtje të njëjtë, të kryera ose të ndryshuara prej financuesve ndërkombëtarë për palët detyruese, të cilat janë në një situatë të njëjtë, do të kryhen apo ndryshohen (sipas rastit) për të përfshirë apo miratuar një normë të re referimi, me qëllim zëvendësimin e Normës mesatare 10 vjeçare të Kundërkëmbimit ose

(b) një përcaktim në mirëbesim nga Banka (përcaktimi duhet të jetë përfundimtar dhe pa gabime të dukshme) që:

(i) (A) administratori i Normës mesatare 10 vjeçare të Kundërkëmbimit apo mbikëqyrësi i tij shpall publikisht që ky administrator nuk ka aftësi paguese ose

(B) është botuar informacion në formën e një dekreti, njoftimi, kërkese, padie në gjykatë, apo të njoftohen autoritetet rregullatore të këmbimit ose ente të ngjashme administrative rregullatore apo gjyqësore, ku të konfirmohet në mënyrë të arsyeshme që administratori i Normës mesatare 10 vjeçare të Kundërkëmbimit nuk ka aftësi paguese; me kusht që në secilin rast, në atë moment, nuk do të ketë administrator pasues që do të vazhdojë të ofrojë Normën 10 vjeçare të Kundërkëmbimit;

(ii) Administratori i Normës Mesatare 10 Vjeçare të Kundërkëmbimit apo mbikëqyrësi rregullator i

Administratorit të Normës Mesatare 10 Vjeçare të Kundërkëmbimit, Sistemi i Rezervës Federale të SHBA-së, një zyrtar falimenti me juridiksion mbi Administratorin e Normës Mesatare 10 vjeçare të Kundërkëmbimit, një autoritet vendim-marrës me juridiksion mbi Administratorin e Normës Mesatare 10 Vjeçare të kundërkëmbimit, një gjykatë apo ent me autoritet të ngjashëm vendim-marrës për falimentimet mbi Administratorin e Normës mesatare 10 Vjeçare të Kundërkëmbimit, shpallin publikisht që Administratori i Normës Mesatare 10 Vjeçare të Kundërkëmbimit ka ndërprerë ose do të ndërpresë ofrimin e Normës mesatare 10 vjeçare të Kundërkëmbimit përfundimisht ose për një periudhë të pacaktuar dhe që në atë moment nuk do të ketë administrator pasues që do të vazhdojë të ofrojë Normën Mesatare 10 Vjeçare të Kundërkëmbimit;

(iii) Mbikëqyrësi rregullator i Administratorit të Normës Mesatare 10 Vjeçare të Kundërkëmbimit, Sistemi i Rezervës Federale të SHBA-së, një zyrtar falimenti me juridiksion mbi Administratorin e Normës mesatare 10 vjeçare të Kundërkëmbimit , një autoritet vendim-marrës me juridiksion mbi Administratorin e Normës Mesatare 10 Vjeçare të Kundërkëmbimit, një gjykatë apo ent me autoritet të ngjashëm vendim-marrës për falimentimet mbi Administratorin e Normës Mesatare 10 Vjeçare të Kundërkëmbimit shpallin publikisht që Norma Mesatare 10 Vjeçare e Kundërkëmbimit është ndërprerë apo do të ndërpritet përfundimisht dhe për një periudhë të pacaktuar dhe që në atë moment nuk do te ketë administrator pasues që do të vazhdojë të ofrojë Normën Mesatare 10 Vjeçare të Kundërkëmbimit ose

(iv) Administratori i Normës mesatare 10 vjeçare të Kundërkëmbimit apo mbikëqyrësi rregullator i Administratorit të Normës Mesatare 10 Vjeçare të Kundërkëmbimit nuk do të jenë më në detyrë apo përfaqësues ose

(v) Banka përcakton në mirëbesim (përcaktimi duhet të jetë përfundimtar dhe pa gabime të dukshme) që Norma Mesatare 10 Vjeçare e Kundërkëmbimit nuk është më e përshtatshme për qëllimin e të qenit normë referimi në lidhje me financimin e dhënë sipas Dokumenteve të Financimit.

Kostoja kapitale: do të thotë kostoja e përgjithshme e ndërtimit të Asetit të Projektit, ku përfshihet çmimi i kontratës, dhe çdo kosto ose shpenzim tjetër që kryhet nga Banka për ose në lidhje me ndërtimin e Aseteve të Projektit plus një Libor i lëvizshëm me normë në rritje në Dollarë Amerikanë, plus Diferencën Totale të Çmimit për çdo vit që aplikohet për çdo Disbursim gjatë Periudhës së Administrimit

Disbursimi: çdo pagesë e kryer në përputhje me rregulloret e zbatueshme të Bankës, të çdo pjese të Shumës së Miratuar për prokurimin e Aseteve të Projektit.

Shuma e Dhurimit: do të thotë alternativa e bankave islamike në përputhje me ligjet e Shariahut kundrejt konceptit tradicional bankar të penalitetit mbi pagesat e vonuara. Alternativa islamike arrin

objektiv të dyfishtë duke shërbyer si frenues i ndërprerjes së pagesave; duke mbrojtur kështu Shitësin dhe në të njëjtën kohë duke parandaluar kostot tradicionale shtesë të interesit për pagesat e vonuara, të cilat nuk janë në përputhje me ligjet e Shariahut, në këmbim të vonesave për kohën shtesë. Shuma e paguar prej Blerësit është për dhurim bamirësie pas zbritjes së çdo kostoje aktuale (duke përfshirë, por jo vetëm, kostot ligjore por duke përjashtuar çdo kosto financimi apo rastësore) në përputhje me ligjet e Shariahut. Kjo është thjesht një shumë, të cilën Blerësi ndërmerr t'ia paguajë Shitësit në rastin e mospagesës në maturim, e cila përfaqëson një dhurim për arsye bamirësie që do të përcaktohet prej Shitësit.

Norma efektive e rritjes: do të thotë Mesatarja e Ponderuar e Normës së Rritjes pjesëtuar me dy.

Dokumentet e Financimit: përbëhen nga kjo Marrëveshje, Kushtet e Përgjithshme, Marrëveshja e Agjencisë, Botimi i Vitit 2020 i Kushteve të Përgjithshme të BIZH-it të zbatueshme për Agjencinë, çdo marrëveshje, kontratë apo instrument që lidhet në vijim të dhe në lidhje me ato pararendëse dhe çdo dokument i mëtejshëm i hartuar ndërmjet Bankës dhe Përfituesit.

Libor: (i) në lidhje me çdo periudhë përkatëse prej një (1) muaj ose më të gjatë, norma e interesit për depozitat për një periudhë që është numri i disa muajve që korrespondon më ngushtë me kohëzgjatjen e periudhës, dhe

(ii) në lidhje me një periudhë përkatëse prej më pak se një muaj, norma e interesit për depozitat në Dollarë Amerikanë për një periudhë prej një (1) muaji (periudha për të cilën merret norma, nga ky moment do të referohet si "Periudhë Përfaqësuese", siç përcaktohet nga Shoqata Britanike e Bankierëve dhe që transmetohet nga Reuter Monitor Money Rate Service apo çdo transmetues i lajmeve financiare në orën 11.00 paradite sipas orës së Londrës ose në një orar të mëvonshëm të pranueshëm nga Banka në ditën (Data e Rivendosur) e cila përkon me dy ditë Pune të Londrës përpara ditës së parë të periudhës përkatëse.

Nëse kjo normë nuk shpallet nga Reuter apo ndonjë transmetues lajmesh financiare, Banka do t'i kërkojë zyrave kryesore të "Bankave të Referencës" në Londër të caktojnë një normë me të cilën i ofrohen depozitat në Dollarë Amerikane nga secila prej tyre, bankave kryesore në tregun ndërbankar në Londër në një shumë të krahasueshme, rreth orës 11 paradite sipas orës së Londrës në Datën e Rivendosur për një periudhë të barabartë me periudhën e përfaqësimit. Nëse jepen të paktën dy oferta, norma do të jetë mesatarja aritmetike e ofertave të dhëna.

Nëse jepen më pak se dy oferta, siç kërkohet, shitësi do t'i kërkojë zyrave kryesore të Bankave të Referencës në Nju Jork të caktojnë një normë me të cilën i ofrohen depozitat në dollarë amerikanë nga secila prej tyre, bankave kryesore në tregun Evropian për një periudhë të barabartë me Periudhën e Përfaqësimit, në një shumë të krahasueshme, rreth orës 11 paradite sipas orës së Nju Jorkut, në ditën që përkon me dy ditë pune te Nju Jorkut pas datës së rivendosur. Nëse jepen të paktën dy oferta, norma do të jete mesatarja aritmetike e ofertave të dhëna.

Për qëllimin e përcaktimit pararendës:

(i) Dita e punës në Londër është një ditë kur bankat janë të hapura për aktivitet normal në Londër.

(ii) Dita e punës ne Nju Jork është një ditë kur bankat janë të hapura për aktivitet normal në Nju Jork.

(iii) Të gjitha përqindjet që rezultojnë nga çdo llogaritje, të cilat përmenden në këtë përcaktim, do të bazohen, nëse nevojitet, në pesë radhë dhjetore.

(iv) Bankat e Referencës: zyrat kryesore në Londër të JP Morgan Chase, Citibank N.A dhe HSBC dhe/ose çdo bankë tjetër e përcaktuar nga Banka në zëvendësim të bankave të lartpërmendura

Data e Maturimit: është data në të cilën duhet të paguhet kësti përfundimtar i pagesës në përputhje me Planin e Pagesës.

Principali i Pashlyer: është shuma e barabartë me Disbursimet Totale e reduktuar në secilën Datë Pagese, me një shumë të barabartë me Komponentin përkatës të Principalit të Kështit të Pagesës.

Dita e Punës për Pagesën: është dita kur bankat janë të hapura për aktivitet tregtar në Arabinë Saudite dhe në qendrën kryesore financiare të Përfituesit, e cila është gjithashtu Ditë Pune e Sigurimeve në SHBA.

Data e pagesës: është data që përkon me gjashtë (6) muaj pas Datës së Parë të Disbursimit dhe si rrjedhojë, data që përkon me gjashtë (6) muaj pas Datës së parë paraardhëse të Pagesës por;

(a) Nëse kjo datë nuk është Ditë Pune për Pagesën, atëherë Dita tjetër e Punës për Pagesën në të njëjtin muaj kalendarik nëse ekziston, ose Dita paraardhëse e Punës për Pagesën, nëse nuk ka, ose;

(b) Përndryshe përkon me një datë pas Datës së Maturimit, **me kusht që periudha prej Datës së Parë të Disbursimit deri në Datën e fundit të Pagesës nuk i kalon tetëmbëdhjetë** (18) vjet.

Kështet e pagesës: janë kështet e pagueshme prej Blerësit kundrejt pagesës së Çmimit të Shitjes, në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të Shitjes dhe Nenin 4.


Komponenti i të Ardhurave të Kështit të Pagesës: është komponenti i të ardhurave/përfitimit në secilin Kést Pagese:

Komponenti i Principalit të Kështit të Pagesës: është shuma e barabartë me komponentin e principalit të secilit Kést Pagese, pagesa e së cilit në çdo Datë Pagese do të reduktojë Principalin e Pashlyer.

Periudha e pagesës: është periudha prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh, duke filluar nga fundi i Periudhës së Planifikimit, me kusht që periudha nga Data e Parë e Disbursimit deri në Datën e Fundit të Pagesës nuk i kalon tetëmbëdhjetë (18) vjet.

Plani i Pagesës: është plani që do ti bashkëngjitet Ofertës së Shitjes dhe që përcakton, përveç të tjerash, Periudhën e Pagesës dhe Kështet e Pagesës.

Enti Përkatës Emërues: është çdo bankë qendrore, autoritet rregullator, ose mbikëqyrës, ose një grup i tyre apo çdo grup apo komitet pune, i sponsorizuar apo kryesuar nga, i miratuar zyrtarisht, i mbledhur dhe krijuar me kërkesën e secilit prej tyre ose


ligj nr. 73, dt. 17.11.2022 teksti.pdf - Adobe Acrobat Pro
File Edit View Window Help
Create
Customize
Tools Sign Comment
Page Thumbnails
Bordit të Stabilitetit Financiar, Bordi i Rezervës Federale,
Banka e Rezervës Federale të Nju Jorkut apo çdo pasues i tyre.
Koha Përkatëse:
është ora 11 paradite (ora e Nju Jorkut)
në Ditën e tretë të Punës për Pagesën e parë paraardhëse të datës përkatëse.
Ndryshimi i pikës së referimit për zëvendësimin:
janë ndryshimet ne Dokumentet e Financimit të pasqyruara në Nenin 4 të këtij dokumenti.
Norma e Referencës së Zëvendësimit:
është norma që përzgjidhet prej Bankës në të drejtën e saj dhe që merr parasysh çdo normë:
(i) të përcaktuar apo rekomanduar zyrtarisht nga administratori i Normës 10 vjeçare mesatare të kundërkëmbimit , duke qenë ICE (ose NYSE Euronext apo çdo ent pasues) ose;
(i) të përcaktuar apo rekomanduar zyrtarisht prej çdo
(ii) Enti Përkatës Emërues, ose;
(iii) të pranuar përgjithësisht në tregun ndërkombëtar
(iv) të financimit për financimet e përbashkëta dypalëshe ose të bashkuara te një përmbajtje të njëjtë prej kredituesve ndërkombëtarë për huamarrësit që janë në situatë të ngjashme si pasuesi i duhur i Normës 10 vjeçare mesatare të kundërkëmbimit siç dëshmohet nga miratimi apo përfshirja e kësaj
Content Editing
Edit Text & Images
Add Text
Add Image
Export File to...
More Content
Add or Edit Link
Add Bookmark
Attach a File
Format
Times New Roman
Edit Using...
Outline Text & Images
Pages
Interactive Objects
Forms
Action Wizard
Text Recognition
Protection
Document Processing
Type here to search
13°C Cloudy
2:09 PM
12/13/2022

(v) norme (ose nëpërmjet zbatimit fillestar apo ndryshimeve) në të paktën dhjetë (10) financime, ose;

(vi) që shpreh si normë përqindjeje vjetore koston e Bankës për shtrirjen e financimit në vijim te Dokumenteve të Financimit prej secilit burim që ajo zgjedh në mënyrë të arsyeshme.

Faqe Transmetimi: është faqja e pasqyrimit në shërbimin përkatës informativ të Reuters, të përcaktuar si faqja "ICESWAP1" ose çdo faqe e tillë që mund ta zëvendësojë atë në shërbimin e informacionit apo çdo shërbim i barazvlefshëm informacioni që mund të emërohet nga personi që jep apo sponsorizon një informacion të tillë, në çdo rast me qëllim pasqyrimin e normave të barazvlefshme apo të krahasueshme kundrejt Normës 10 vjeçare mesatare të Kundërkëmbimit

SIFMA: është Industria e Sigurimeve dhe Shoqata e Tregjeve Financiare apo çdo pasues i tyre.

Norma e SHKËMBIMIT, është norma e përzgjedhur prej Bankës në llogaritjen e Çmimit të Shitjes, Një (1) Ditë Pune përpara përfundimit të Periudhës së Planifikimit nga norma më e ulët e përftuar, duke krahasuar,

(a) normat e kuotuara dhe përftuara prej institucioneve që merren me SHKËMBIMIN dhe të pranueshme nga Banka, si dhe

(b) normat e kuotuara nga Bloomberg apo çdo rrjet tjetër lajmesh financiare të pranueshme nga Banka.

Për qëllim të qartësisë, çdo normë e përftuar apo e llogaritur do të jetë për një shkëmbim amortizues me lëvizshmëri-fikse, duke pasur NPV zero në fillim për të cilin;

(i) monedha e të dyja fazave është në Dollarë Amerikanë.

(ii) të dyja fazat kanë një maturim të barabartë me Periudhën e Pagesës.

(iii) te dyja fazat i nënshtrohen planit të dakordësuar të amortizimit të Kostos Kapitale.

(iv) pjesa fikse ka një pagesë kuponi me një frekuencë gjysmë vjetore dhe bazë numërimi 30/360 ditë

(v) pjesa e lëvizshmërisë ka një pagesë kuponi me një Libor 6 mujor në Dollarë Amerikanë (p.sh. me frekuencë gjysmë vjetore dhe bazë numërimi aktuale 360 ditore.

Të dyja fazat përdorin kurba ndërkëmbimi të cilët gjenden në Bloomberg (Swap Manager-SWPM) për qëllime të përcaktimit të çmimeve. Në këtë rast, norma e shkëmbimit do të jetë kuponi i pjesës fikse.

Disbursimet totale: është Çmimi i Blerjes, i cili është një shumë e barabartë me totalin e të gjitha disbursimeve që i ofrohet përfituesit prej bankës.

Faktori Total Ponderues për Disbursimin:	është një shumë e barabartë me shumatoren e të gjithë Faktorit Ponderues për Disbursimet.
Diferenca Totale e Çmimit:	është 155pb (Njëqind e Pesëdhjetë e Pesë pikë bazë).
Ditë Pune e Sigurimeve në SHBA:	është çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës ose një ditë kur SIFMA rekomandon që departamentet e të ardhurave fikse të anëtarëve të saj janë të mbyllura gjatë gjithë ditës për qëllimet e tregtimit të letrave me vlerë të Qeverisë së SHBA-ve.
Faktori mesatar Ponderues	është një normë vjetore, përqindje e llogaritur si më poshtë: $100 \times \frac{\text{(Faktori total ponderues për Disbursim)}}{\text{Disbursimet Totale}}$
Norma e Rritjes së Mesatares së Ponderuar:	është një shumë e barabartë me produktin e secilës shume Disbursimi dhe Normën përkatëse Individuale të Rritjes
Norma 10 Vjeçare Mesatare e Kundërkëmbimit:	është norma vjetore e kundërkëmbimit për transaksionet e shkëmbimit ne Dollarë Amerikanë me një maturim 10 vjeçar (të shpallur mbi baza gjysmëvjetore), të shprehura në përqindje, e cila shfaqet ne Faqen e Transmetimit në Kohën Përkatëse, me kusht që në rastin kur kjo normë është negative, Norma 10 Vjeçare e kundërkëmbimit duhet të konsiderohet të jetë zero

Neni-2 PROKURIMI I ASETEVE TË PROJEKTIT NGA BANKA

2.1 **Prokurimi:** Banka do të përdorë Shumën e Miratuar për të prokuruar Asetet e Projektit, dhe në përputhje me premtimin për blerje, të specifikuar në Nenin 3 të këtij dokumenti, do t'ia shesë ato Përfituesit.

2.2 **Asetet e Projektit**: Asetet e Projektit janë ato që përshkruhen në Skedulin I të këtij dokumenti.

2.3 **Shuma e Miratuar**: Shuma e Miratuar për blerjen e Aseteve të Projektit nga Banka është 56,800,000 USD (pesëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind mijë Dollarë Amerikanë).

2.4 **Periudha e Prokurimit:** Banka do të blejë Asetet e Projektit në fund të Periudhës së Administrimit, me përjashtim të rasteve kur Palët bien dakord ndryshe. Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, periudha e Planifikimit është Tridhjetë e Gjashtë (36) muaj prej Datës së Disbursimit të Parë.

Neni-3 PREMTIMI PËR BLERJEN E ASETEVE TË PROJEKTIT NGA BANKA

3.1 Përfituesi pranon që Banka do të blejë Asetet e Projektit, si dhe titullin dhe pronësinë në vijim, me kusht që Përfituesi të premtojë që do të blejë Asetet e Projektit nga Banka.

3.2 Si rrjedhojë, Përfituesi premton në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar që të blejë Asetet e Projektit prej Bankës në përputhje me kushtet e specifikuara në Nenin 4 të këtij dokumenti.

3.3 Pronësia e Aseteve të Projektit do të kalojë nga Banka tek Përfituesi pas përfundimit të një Marrëveshjeje Shitje (e cila përbëhet prej Ofertës së Shitjes dhe Pranimit të Shitjes).

Neni-4 SHITJA E ASETEVE TË PROJEKTIT

4.1 **Kushtet e Përgjithshme të Shitjes**: Blerja e Aseteve të Projektit nga Përfituesi (si Blerësi) dhe shitja e tyre prej Bankës (si Shitësi) do t'i nënshtrohet Pjesës II (Kushtet e Përgjithshme të Shitjes) të përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme, veçanërisht Seksionet 3 dhe 4, si dhe klauzolat e këtij Neni 4.

4.2 **Parapagimi**: Parapagimi nuk parashikohet në këtë Marrëveshje.

4.3 **Rënia e LIBOR-it/Kursit të Kundërkëmbimit:** Pavarësisht ndonjë pike për të kundërtën në këtë dokument apo në ndonjë dokument tjetër financimi, në vijim të një përcaktimi në mirëbesim nga Banka (përcaktim që duhet të jetë përfundimtar dhe pa gabime të dukshme) që ka ndodhur një Rast Zëvendësimi të Pikës së Referimit:

(a) Banka, në të drejtën e saj të vetme, mund të propozojë ndryshime të kësaj Marrëveshjeje apo të ndonjë Dokumenti Financimi, për të garantuar përdorimin Normës së Referencës së Zëvendësimit dhe

(i) të harmonizojë klauzolat e çdo Dokumenti Financimi me përdorimin e Normës Referuese të Zëvendësimit;

(ii) të mundësojë që Norma e Referencës së Zëvendësimit të përdoret për llogaritjen e çdo Norme Rritjeje (duke përfshirë, pa kufizime, çdo ndryshim pasues që kërkohet për të mundësuar përdorimin e Normës së Referencës së Zëvendësimit për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje);

(iii) të zbatojë marrëveshjet e tregut të zbatueshme për Normën e Referencës së Zëvendësimit;

(iv) të marrë masa për rënien përkatëse (dhe çrregullimet e tregut) për atë Normë Reference të Zëvendësimit;

(v) të rregullojë çmimet për të zvogëluar apo eliminuar, në masën e lejueshme, çdo transferim të vlerës ekonomike nga njëra palë tek tjetra si rezultat i zbatimit të Normës së Referencës të Zëvendësimit me anë të Rregullimit të Diferencës së Çmimit ;

(vi) të sigurojë çdo ndryshim tjetër teknik, administrativ apo operacional në çdo Dokument Financimi ku Banka e çmon të nevojshëm për të pasqyruar miratimin dhe zbatimin e Normës së Referencës të Zëvendësimit dhe Rregullimit të Diferencës së Çmimit për të mundësuar administrimin nga ana e Bankës në përputhje me praktikat e tregut (ose, nëse Banka përcakton që përdorimi i një pjese të caktuar të praktikave të tregut nuk është i mundur nga pikëpamja administrative ose nëse Banka përcakton që nuk ekzistojnë praktika tregu për administrim, Banka mund të përcaktojë që është i nevojshëm prezantimi i **Ndryshimeve Konformuese të Pikës së Referimit,** në lidhje me administrimin e Dokumenteve të Financimit si dhe ndryshimet teknike, administrative dhe operacionale);

(b) Nëse Banka synon që, në të drejtën e saj të vetme, të propozojë Ndryshimin e Pikës së Referimit për Zëvendësimin, ajo duhet të njoftojë Përfituesin mbi secilën nga pikat e mëposhtme në një ose më shumë njoftime (secili duhet të jetë **Njoftim i Zëvendësimit të Pikës së Referimit)** dhe duhet të përcaktojë:

(i) që ka ndodhur një rast i Zëvendësimit të Pikës së Referimit dhe të citojë paragrafin përkatës të përcaktimit;

(ii) normën e propozuar të Referencës për Zëvendësimin;

(iii) Rregullimin e Diferencës së Çmimit,

(iv) ndryshime të tjera për Dokumentet e Financimit të cilat mund të përfshijnë çdo Ndryshim Konformues të Pikës së Referimit dhe;

(v) datën kur duhet të hyjë në fuqi Ndryshimi i Pikës së Referimit për Zëvendësimin (që nuk duhet të jetë përpara fundit të Datës së Përgjigjes, siç përcaktohet më poshtë);

(c) nëse Përfituesi:

(i) (i) bie dakord me shkrim (marrëveshje e cila është e parevokueshme) përpara Datës së Përgjigjes me ndryshimet e paraqitura në Njoftimin e Zëvendësimit të Pikës së Referimit (apo ne çdo Njoftim të rishikuar të Zëvendësimit të Pikës së Referimit të dakordësuar ndërmjet Bankës dhe Përfituesit përpara Datës së Përgjigjes) dhe/ose;

(ii) nuk njofton Bankën shprehimisht me shkrim në përputhje me paragrafin (d) më poshtë përpara Datës së Përgjigjes që ai kundërshton në mirëbesim Normën e Referencës së Zëvendësimit dhe Rregullimin e Diferencës së Çmimit të përcaktuara që nga ai moment dhe që ka bindjen me mirëbesim që nuk është Rasti për Ndryshimin e Pikës së Referimit,

atëherë Dokumenti i zbatueshëm i Financimit duhet të ndryshohet në përputhje me termat e Njoftimit të Zëvendësimit të Pikës së Referimit, duke përfshirë Ndryshimet Konformuese të Pikës së Referimit dhe këto ndryshime do të jenë përfundimtare dhe detyruese për Përfituesin dhe do të hyjnë në fuqi në datat përkatëse të specifikuara në Njoftimin e Zëvendësimit të Pikës së Referimit (ose duke iu referuar paragrafit C më lart, në datën kur Përfituesi ka paraqitur pëlqimin me shkrim për ndryshimet e paraqitura në Njoftimin e Zëvendësimit të Pikës së Referimit) pa firmë, veprim apo leje të mëtejshme të Përfituesit (pavarësisht ndonjë kërkese tjetër të përfshirë në këtë dokument apo në ndonjë dokument tjetër financimi);

(d) Nëse Përfituesi njofton Bankën brenda 10 Ditësh Pune nga data e Njoftimit të Zëvendësimit të Pikës së Referimit **(Data e Përgjigjes)** që ai kundërshton në mirëbesim Normën e Referencës së Zëvendësimit dhe Rregullimin e Diferencës së Çmimit të paraqitura në njoftim dhe që ka bindjen me mirëbesim që nuk është Rasti për Ndryshimin e Pikës së Referimit, Përfituesi gëzon të drejtën t'i kërkojë Bankës me shkrim një shlyerje të hershme të financimit të dhënë në vijim të Dokumenteve të Financimit **(Kërkesë për Shlyerje të Hershme**). Brenda 10 ditësh pune nga marrja e kërkesës për shlyerje të hershme prej Bankës, ajo (Banka) duhet t'i dërgojë përfituesit një njoftim me shkrim ku duhet të përcaktojë:

(i) datën kur duhet të hyjë në fuqi shlyerja e hershme, e cila duhet të përcaktohet prej Bankës në të drejtën e saj të vetme (**Data e Shlyerjes së Hershme**) dhe;

(ii) shumën që duhet t'i paguajë Përfituesi Bankës në Datën e Shlyerjes së Hershme, e cila duhet të jetë shuma e çdo Disbursimi që Banka i ka dërguar Përfituesit deri në Datën e Shlyerjes së Hershme plus çdo shtesë-rritje të Paradhënies së papaguar për çdo Disbursim deri në datën e Shlyerjes së Hershme (të llogaritur në përputhje me Nenin 4 **(Shuma e Shlyerjes së Hershme**),

dhe më pas Përfituesit i kërkohet të paguajë shumën e plotë të Shlyerjes së Hershme në Datën e Shlyerjes së Hershme dhe shlyerjen përfundimtare të financimit të dhënë në vijim të Dokumenteve të Financimit. Për shmangien e çdo dyshimi, nëse përfituesi nuk e njofton Bankën në datën e përgjigjes, siç specifikohet në nënseksionin (d), atëherë do të zbatohen Norma e Referencës së Rikthimit dhe Rregullimi i Diferencës së Çmimit në Dokumentin e Financimit sipas datës së përcaktuar në Njoftimin e Zëvendësimit të Pikës së Referimit.

(e) në mbështetje të klauzolave pararendëse, në lidhje me zbatimin e Normës së Referencës së Zëvendësimit dhe Rregullimit të Diferencës së Çmimit dhe në vijim të miratimit të Ndryshimit të Pikës së Referimit të Zëvendësimit, Banka gëzon të drejtën e saj ekskluzive për të kryer Ndryshimet Konformuese të Pikës së Referimit herë pas here dhe, pavarësisht çdo deklarimi të kundërt në këtë dokument apo në çdo Dokument tjetër Financimi, çdo ndryshim në zbatim të Ndryshimeve Konformuese të Pikës së Referimit do të hyjë në fuqi pas dorëzimit të një ndryshimi ku përfshihen Ndryshimet Konformuese të Pikës së Referimit pa firmë, veprim apo leje të mëtejshme të përfituesit (pavarësisht ndonjë kërkese tjetër të përfshirë në këtë dokument apo në ndonjë dokument tjetër financimi);

(f) Banka nuk do të jetë përgjegjëse apo nuk do të ketë ndonjë detyrim për përdorimin e të drejtës së saj apo marrjes së vendimeve në lidhje me çështje që mbulohen prej Nenit 4.3, duke përfshirë, por pa u kufizuar në Rastin e Zëvendësimit të Pikës së Referimit, zbatimin apo mungesën e Ndryshimeve Konformuese të Pikës së Referimit apo ndryshimeve të ngjashme në Dokumentet e Financimit, dorëzimin apo mosdorëzimin e Njoftimit për Ndryshimin e Pikës së Referimit dhe përcaktimin ose jo të Normës së Referencës të Zëvendësimit dhe Rregullimit të Diferencës së Çmimit. Çdo përcaktim, vendim apo zgjedhje që Banka mund të bëjë sipas Nenit 4.3, duke përfshirë çdo përcaktim në lidhje me përmbajtjen, normën apo rregullimin, zhvillimin ose të një rasti, rrethane ose date dhe çdo vendim për marrjen ose mos-marrjen e një vendimi do te jetë përfundimtar dhe detyrues përveç gabimeve të dukshme dhe mund të kryhet në të drejtën ekskluzive të bankës dhe pa lejen e Përfituesit, përveç rasteve kur kërkohet shprehimisht nga Neni 4.3.

4.4 **Çmimi i Shitjes:** Çmimi i Shitjes do të llogaritet në fund të Periudhës së Planifikimit, duke u bazuar në Koston Kapitale plus një Kurs Shkëmbimi në Rritje të Liborit për 6 muaj në Dollarë Amerikanë që mbizotëron në periudhën e amortizimit të kapitalit plus Diferencën e Çmimit për çdo vit. Kostoja Kapitale do të përcaktohet duke u bazuar në disbursimet totale në fund të Periudhës së Planifikimit ose kohës së shitjes, plus Liborin e lëvizshëm në rritje për 6 muaj në Dollarë Amerikanë plus Diferencën e Çmimit për çdo vit.

4.5 **Shuma e Çmimit të Shitjes**: Shuma e Çmimit të Shitjes që do t'i paguhet Bankës do të jetë neto, pa përfshirë Pagesën e Paradhënies, nëse është e zbatueshme, dhe ndryshe do të llogaritet dhe paguhet si më poshtë:

(a) Në fund të periudhës së Planifikimit, Banka do të përgatisë Skedulin e Pagesës duke përcaktuar Shumën e Çmimit të Shitjes së bashku me Kështin e Pagesës që duhet të paguhet në Datën e Pagesës gjatë Periudhës së Pagesës, në përputhje me klauzolat e Nenit 4.5 dhe do t'ia dorëzojë Blerësit së bashku me Ofertën e Shitjes;

(b) çdo Kést Pagese duhet të jetë i njëjtë dhe llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$P = \frac{r\,(TD)}{1 - (1+r)^{-n}}$$

Ku:
P= Kësti i Pagesës

TD = Disbursimet Totale
r= Norma Efektive në rritje
n= numri total i datave të pagesës gjatë Periudhës së Pagesës, siç përcaktohet prej Bankës

(c) **Komponenti i Të Ardhurave në Këstin e Pagesës për çdo Këst Pagese që duhet të paguhet në Datën e Pagesës, do të jetë një shumë e barabartë me produktin e (i) Normës Efektive në Rritje dhe (ii) Principalin e Pashlyer**

(d) Komponenti i Principalit në Këstin e Pagesës për çdo Këst Pagese që duhet të paguhet në Datën e Pagesës, ku shuma e Principalit të Pashlyer do të zvogëlohet në çdo Datë Pagese, do të jetë një shumë e barabartë me diferencën ndërmjet Këstit të Pagesës që duhet të paguhet në Datën e caktuar të Pagesës dhe Komponentit të të Ardhurave të Këstit të Pagesës të këtij Kësti Pagese dhe;

(e) **Pavarësisht ndonjë deklarate të kundërt në këtë dokument, Banka dhe Blerësi mund të bien dakord bashkërisht për ndryshime të mundshme në klauzolat e parashtruara në Nenin 4, si për shembull, ndër të tjera, Shumën e Çmimit të Shitjes dhe Skedulin e Pagesës.**

4.6 **Oferta e Shitjes dhe Pranimi i Ofertës**: Oferta e Shitjes dhe Pranimi i Ofertës duhet të jetë kryesisht në formën e paraqitur në Skedulin II

Neni-5 HYRJA NË FUQI

Në vijim të datës së nënshkrimit të deklaruar në fillim të këtij dokumenti, kjo Marrëveshje do të shpallet efektive prej BIZH-it pas marrjes së një njoftimi me shkrim nga përfituesi, ku konfirmohet përfundimi i procedurave të brendshme në lidhje me ratifikimin dhe hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni-6 KOMUNIKIMI

6.1. Përfituesi emëron një përfaqësues me emër dhe titull që ka të drejtën për të vepruar si përfaqësues i autorizuar për qëllimet e Seksionit 7.9 të Pjesës I (Kushtet e Përgjithshme të Financimit të Projektit) të Kushteve të Përgjithshme. Çdo njoftim në lidhje me këtë Marrëveshje do të dërgohet në adresat e poshtëshënuara të Palëve:

Për Përfituesin:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tel: +3554228405
Faks: +_____
Email: sekretariamin@financa.gov.al

Për BIZH-in:
8111 King Khalid St. Al Nuzlah Al Yamania Dist. Unit No.1 Jeddah-22332-2444, Kingdom of Saudi Arabia
Tel: +966 12 6361400
Faks: +966 12 6366871
Email: IDBARCHIVES@isdb.org

Neni-7 KOPJET DHE NËNSHKRIMET

7.1. Kjo Marrëveshje, përfshirë dhe ndryshimet, mund të nënshkruhet në të gjitha kopjet, ku secila prej tyre mund të konsiderohet një marrëveshje origjinale dhe ku secila prej tyre përbën një marrëveshje të vetme. Kopjet e kësaj Marrëveshjeje mund të zbatohen dhe nënshkruhen me nënshkrim elektronik (duke përfshirë dhe formatin e një dokumenti portabël) nga secili prej palëve dhe pala marrëse mund të bazohet në marrjen e këtij dokumenti të dërguar në mënyrë elektronike njëlloj sikur të ishte marrë dokumenti origjinal.

KJO MARRËVESHJE hyn në fuqi në datën e deklaruar në fillim të këtij dokumenti.

Skeduli -I: PËRSHKRIMI I PROJEKTIT, ASETET E PROJEKTIT DHE PLANI I FINANCIMIT

Seksioni I- Përshkrimi i Projektit

Financimi shtesë do të mbulojë kostot (i) punë të prapambetura nga projekti fillestar (ii) punime shtesë për trajtimin e rrëshqitjeve të tokës të cilat janë të nevojshme për shkak të aktivitetit sizmik të kohëve të fundit, stabiliteti i pjerrësisë dhe mbrojtja e muraturave dhe skarpateve, kanalet e fibrave optike, shënjimet rrugore, sinjalistika dhe mbrojtëset anësore prej metali për të rritur sigurinë, (iii) rrugët lidhëse dytësore për të ofruar mundësi më të mëdha hyrjeje dhe lidhjeje me rrugët e tjera, (iv) përforcimi i urave dhe strukturave të tjera për t'i bërë ato më rezistente ndaj aktivitetit sizmik, (v) infrastruktura elektromekanike dhe aparaturat e tuneleve, si dhe (vi) punime të tjera të ndryshme.

Një përmbledhje e punëve të prapambetura që do të përfundohen sipas Marrëveshjes së Shitjes me Këste, jepet në tabelën e mëposhtme:

#	Aktivitetet Kryesore	Seksioni - 1	Seksioni - 2
1	Punime tokësore (përfshirë gërmime, mbushje dhe drenazhime anësore	20%	10%
2	Shtresa asfalti	72%	68%
3	Shenjimet dhe sinjalistika rrugore	100%	100%
4	Mbrojtja dhe stabilizimi i pjerrësive	100%	100%
5	Strukturat (Muret mbajtës, nënkalesat e tubacioneve	17%	25%
6	Urat dhe urë-rrugët	39%	25%
7	Punime elektromekanike në tunele	-	100%

Seksioni II - Asetet e Projektit

Asetet e Projektit në këtë Financim Shtesë Shitjeje me Këste do të përbëhen prej 2 lloj punimesh (a) Punime të Nevojshme të Prapambetura dhe (b) Punime të Nevojshme për Sigurinë Sizmike, Konektivitetin dhe Sigurinë rrugore dhe Përmbushjen e Standardeve të paraqitura si më poshtë:

A. Përfundimi i Punimeve të Nevojshme të Prapambetura do të kryhet me investimin e US$ 23,709, 034.49

Aktivitetet e prapambetura që nevojiten për të përfunduar punimet në vazhdim dhe aktivitetet e prapambetura sipas financimit fillestar:

Punime tokësore – ku përfshihen gërmimet, mbushjet dhe drenazhimet anësore,

Shtresat e zhavorrit dhe betonit në themel
Shtresat e Asfaltit dhe mbushjet

Ndërtimi i strukturave/drenazhime (mure mbajtës dhe nënkalesat e tubacioneve, etj)

Ndërtimi i urave 1,2,3,4 dhe
Zëra të tjerë si Sistemi Terramesh, Muret Mbajtës, kanalet anësore etj

Të dhënat sipas zërave të punimeve nën këtë kategori paraqiten si më poshtë (të gjithë shumat janë në Dollarë Amerikanë (US$)

Të dhënat sipas zërave të punimeve nën këtë kategori paraqiten si më poshtë (të gjithë shumat janë në Dollarë Amerikanë (US$)

#	Artikuj a Pune	Seksioni -1 (2.9 km - 18.0 km)		Seksioni -2 (18.0 km - 133.8 km)		Kostoja totale e përfundimit
		%	Kostoja	%	Kostoja	
1	Punimet e Tokës (përfshirë gërmimin, mbushjen, kullimin anësor etj.)	8%	1,153,325.00	18%	1,825,380.77	2,978,705.77
2	Shtresa bazë agregat	9%	1,196,213.00	4%	403,285.35	1,599,498.35
3	Baza asfaltike dhe shtresa e sipërme	29%	3,968,859.37	41%	4,049,529.99	8,018,389.36
4	Strukturat (muret mbajtës, kanalet anësore etj.)	17%	2,381,921.83	21%	2,058,434.49	4,440,356.32
5	Ndërtimi i Urave 1,4	11%	1,450,000.00	0%	-	1,450,000.00
6	Ndërtimi i Urave 2,3	17%	2,384,795.00	0%	-	2,384,795.00
7	Artikuj të tjerë si Terramesh, muri Gabion, ulluqe etj, duke përfshirë artikujt e përgjithshëm	9%	1,245,021.14	15%	1,516,874.25	2,761,895.39
8	Kanal me fije optike	0%	-	1%	75,394.10	75,394.10
	TOTALI		**13,780,135.34**		**9,928,898.95**	**23,709,034.29**

B. Përfundimi i Punimeve të Nevojshme për Sigurinë Sizmike, Konektivitetin dhe Sigurinë rrugore dhe Përmbushjen e Standardeve do të kryhet me investimin prej 22,531,505,96 Dollarë Amerikanë (US$)

Punimet e kërkuara për Sigurinë Sizmike, Konektivitetin dhe Sigurinë Rrugore dhe që konsiderohen të nevojshme për të përmbushur kërkesat kombëtare për sigurinë rrugore, funksionalitetin dhe sigurinë sizmike janë:	Trajtimi i zonave ku ka rrëshqitje të tokës (i paparashikuar) Stabilizimi dhe mbrojtja e pjerrësive (i paparashikuar) Përmirësimi i shënjimeve dhe sinjalistikës rrugore (Thelbësore) Instalimi i barrierave metalike anësore (Rritja e sigurisë) Ndërtimi i Tubacioneve të Fibrave Optike (Përmirëson komunikimin) Ndërtimi i rrugëve dytësore (lehtëson lidhjen dhe aksesin) Përmirësimi i projektit të urave 1, 2, 3 dhe 4 (Siguria Sizmike) Infrastruktura elektromekanike dhe aparaturat për tunelet S1 dhe S2 (Kërkesë standarde e BE-së) Linja e transmetimit 20 KV

Të dhënat sipas zërave të punimeve nën këtë kategori paraqiten si më poshtë (të gjitha shumat janë në Dollarë Amerikanë (US$)

#	Artikuj Pune	Seksioni -1 (2.9 km - 18.0 km)		Seksioni -2 (18.0 km - 133.8 km)		Kostoja totale e përfundimit
		%	Kostoja	%	Kostoja	
1	Mbrojtja nga rrëshqitja e tokës dhe shpatet	29%	4,000,000.00	52%	5,182,392.57	9,182,392.57
2	Mobilje rruge, Shenjat, Sinjalistika	3%	415,055.50	2%	205,258.50	620,314.00
3	Mbrojtëse të trarëve metalikë (për të përmirësuar sigurinë)	10%	1,440,315.60	22%	2,158,755.00	3,599,070.60
4	Terramesh, mur gabion, ulluqe etj, përfshirë artikujt e përgjithshëm	6%	828,760.00	8%	838,233.33	1,666,993.33
5	Rrugët dytësore (përmirësimi i aksesit)	4%	580,484.51	0%	-	580,484.51
6	Kanali i fibrës optike (përmirëson komunikimin)	3%	467,276.55	0%	-	467,276.55
7	Përmirësimet e urave 5, 6, 7	0%	-	27%	2,637,845.80	2,637,845.80
8	Infrastruktura elektromekanike dhe aparatet e tuneleve	0%	-	35%	3,497,128.60	3,497,128.60
9	Linja e Transmetimit 20 Kv	0%	-	3%	280,000.00	280,000.00
	TOTALI		7,731,892.16		14,799,613.80	22,531,505.96

SEKSIONI III – PLANI I DETAJUAR I FINANCIMIT TË PROJEKTIT

Kostoja totale e rishikuar e projektit ALB-0036 dhe ALB-1011, pas përfshirjes së financimit shtesë nga BIZH dhe SFZH (Fondi Saudit për Zhvillimin) vlerësohet të jetë 258.55 milionë Dollarë Amerikanë (US$). Financimi shtesë nga BIZH për projektin ALB-1011 është 56.8 milionë Dollarë Amerikanë (US$). Qeveria e Shqipërisë do të paguaje veçmas të gjitha taksat, tatimet dhe TVSH-në që lidhen me Projektin. Detajimi i kostove dhe përbërësve të Projektit specifikohet në tabelën e mëposhtme.

Shumat në dollarë Amerikanë

#	Përbërësit e Projektit	BIZH			Bashkë Financues- Fondi Saudit për Zhvillim			QSH	Kostoja totale
		Financimi origjinal g*	Financimi shtesë g*	Totali	Financimi origjinal g	Financimi shtesë g	Totali		
1	Blerja e tokës dhe punime të tjera përgatitore	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	2,50	2,50
2	Punime Civile	116,79	46,24	163,03	23,05	43,00	66,05	0,00	229,08
3	Shërbime Konsulence	7,57	3,05	10,62	1,76	1,34	3,10	0,00	13,72
4	Mbështetje për Menaxhimin e Projektit	0,59	0,39	0,98	0,19	0,21	0,40	0,00	1,38
5	Auditimi Financiar	0,05	0,02	0,07	0,00	0,00	0,00	0,00	0,07
Kostoja Bazë Totale		125,00	49,70	174,70	25,00	44,55	69,55	2,50	246,75
Të Paparashikuara		0,00	7,10	7,10	0,00	4,45	4,45	0,25	11,80
Kostoja totale		125,00	56,80	181,80	25,00	49,00	74,00	2,75	258,55

* *Shumat sipas alokimeve aktuale sipas financimit fillestar*

Shtojca-II FORMATI I OFERTËS SË SHITJES DHE PRANIMI I SHITJES
(TË PRINTOHET NË LETËR ZYRTARE ME STEMË)

Vendosni adresën e Përfituesit:
Tel.
Faks:
Email:

Ref: **OFERTË SHITJEJE NË LIDHJE ME – VENDOSNI DETAJET E PROJEKTIT – TITULLIN DHE KODIN**

I/e nderuar Zonjë/Zotëri, Ne i referohemi:

(i) Marrëveshjes së Amendimit **(Marrëveshja e Amendimit**) të nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Blerësi) dhe Bankës Islamike të Zhvillimit (Shitësi) në _____/_____/_____G;

(ii) Kushtet e Përgjithshme të Shitjes si Pjesa II e Botimit të vitit 2020, Kushteve të Përgjithshme të BIZH-it të Zbatueshme për Financimet e Shitjes me Këste **(Kushtet e Përgjithshme);** dhe

(iii) Njoftimi i Dorëzimit që vërteton se Përfaqësuesi/Agjenti ka marrë në dorëzim Asetet e Projektit (kopje bashkëlidhur).

Ku:

(a) Sipas Nenit 3 të Marrëveshja së Amendimit, Blerësi i ka premtuar Shitësit të blejë Asetet e Projektit, siç specifikohet në Marrëveshjen e Ndryshimit;

(b) Në vijim të premtimit të Blerësit për blerje, Shitësi ka prokuruar
Asetet e Projektit dhe ka fituar të drejtën dhe zotërimin mbi Asetet e Projektit; dhe

(c) Shitësi ekzekuton Ofertën e Shitjes për shitjen e Aseteve të Projektit Blerësit në përputhje me termat e përshkruar në këtë dokument.

Tashmë, si rrjedhojë

(i) Me përjashtim të rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorur në Ofertën e Shitjes do të kenë të njëjtin kuptim si në Marrëveshjen e Ndryshimit dhe/ose Pjesën II **(Kushtet e Përgjithshme të Shitjes)** të Kushteve të Përgjithshme (nëse parashtrohen në atë dokument apo i referohen një dokumenti tjetër).

(ii) Në përputhje me Seksionin 3.2 të Kushteve të Përgjithshme të Shitjes dhe Nenin 4 të Marrëveshjes së Ndryshimit, ne (si Shitës) ju ofrojmë juve (si Blerës) blerjen e Aseteve të Projektit në përputhje me të dhënat e mëposhtme:

(a) **Asetet e Projektit**: identifikoni Asetet e Projektit

(b) **Çmimi i Blerjes**: Çmimi i Blerjes është – vendosni shumën fikse këtu, bazuar në Disbursimet totale

(c) **Shuma e Përfitimit/Rritjes**: përfitimi/rritja – vendosni shumën fikse këtu, bazuar ne klauzolat e Neneve 4.4 dhe 4.5 te Marrëveshjes së Ndryshimit

(d) **Pagesa Paradhënie**: Pagesa e Paradhënies: Pagesat e Paradhënies nuk janë parashikuar sipas kësaj Marrëveshjeje

(e) **Shuma e Çmimit të Shitjes**: Shuma e çmimit t ë shitjes do të jetë – vendosni shumën fikse këtu, bazuar në Çmimin e Blerjes, plus Përfitimin/Rritjen dhe klauzolat e detajuara të Neneve 4.4 dhe 4.5 të Marrëveshje së Ndryshimit. Shuma është neto dhe nuk përfshin Paradhënien

(f) **Periudha e Pagesës**: vendosni përmbajtjen këtu

(g) **Kështet e Pagesës**: Shuma e Çmimit të Shitjes do t'i paguhet Bankës në – vendosni numrin këtu – Këste Pagesë në përputhje me Planin e Pagesës bashkëlidhur këtij dokumenti

(h) **Llogaria e Pagesës**: Kështet e Pagesës do të paguhen në çdo datë të caktuar në Llogarinë tonë të Pagesës

	Dollar Amerikan	**Paund Britanik**	**Euro**	
Emri i Llogarisë	Islamic Development Bank, Jeddah, Saudi Arabia (Swift ISLDSAJEXX)			
IBAN:	GB36SINT60928000159137	GB89SINT60928000159127	FR7643899000019696500151088	FR7643899000019696500151088
Nr. i Llogarisë	159111	159137	159127	96965 001 51 0
Adresa e Bankës	Gulf International Bank (UK) Ltd, One Knightsbridge, London United Kingdom (Swift SINTGB2LXXX)			Union de Basques Arabes et Françaises 92523 Paris, Neuillz Cedex France, (Swift UBAFFRPP)
Banka Korrespondente	HSBC Bank, 452 Fifth Avenue New York, NY 10018, USA SWIFT (MRMDUS33XXX)		Deutche Bank AG Frankfurt AM Main SWIFT (DEUTDEFFXXX)	Credit Agricole SA paris, France SWIFT (AGRIFRPP)

(i) **Shuma e Donacionit**: Nëse një shumë që duhet paguar prej Blerësit (Shuma e Papaguar) ndaj Shitësit nuk paguhet në datën e caktuar, përveç pagesës për Shumën e Papaguar, Blerësi ndërmerr të paguajë dhe një shumë si Donacion/Dhurim në përputhje me Seksionin 4.10 të Kushteve të Përgjithshme të Shitjes Për të llogaritur Shumën e Donacionit, periudha që fillon me Datën e Caktuar të pagesës dhe që përfundon me ditën kur përmbushet plotësisht detyrimi i Blerësit për të paguar Shumën e Papaguar, do të referohet si Periudha e Papaguar. Shuma e Donacionit do të llogaritet si:

(Shuma e Papaguar x 1% x Periudhë e Papaguar) / 365 Ditë)

Shuma e Donacionit nuk duhet të llogaritet mbi ose me Shumën e Papaguar në asnjë rrethanë. Shuma e pagueshme e Donacionit duhet të kufizohet në vlerën më të larte të Shumës së Donacionit të llogaritur më lart ose shumë që Shitësi i njofton Blerësit si kosto aktuale e faturuar mbi Shitësin si rezultat i mospagesës të Shumës së Papaguar prej Blerësit në Datën e Caktuar.

Blerësit nuk do t'i kërkohet të paguaje Shumën e Donacionit nëse Blerësi mund të provojë, me pëlqimin e arsyeshëm të Shitësit, që pamundësia e Blerësit për të kryer pagesën e Shumës së Papaguar nuk është për shkak të paaftësisë me dashje për të paguar.

Gjithashtu, Blerësi do të jetë i detyruar të mbulojë të gjitha kostot ligjore dhe shpenzimet e tjera direkte (por duke përjashtuar kostot e financimit apo ato rastësore) që i faturohen Shitësit si rezultat i mos pagesës të Shumës së Papaguar prej Blerësit në Datën e Caktuar.

Çdo Shumë Donacioni duhet të paguhet në llogarinë e mëposhtme të veçantë, të dedikuar të BIZH-it:

	Euro	Dollar Amerikan
Emri i Llogarisë	Islamic Development Bank, Jeddah, Saudi Arabia (SWIFT ISLDSAJEXX)	
IBAN:	GB67SINT60928000159135	GB40SINT60928000159136
Nr. i Llogarisë	159135	159136
Adresa e Bankës	Gulf International Bank (UK) Ltd, One Knightsbridge, London United Kongdom(Swift SINTGB2LXXX)	
Banka Korrespondente	Deutche Bank AG Frankfurt AM Main SWIFT (DEUTDEFFXXX)	HSBC Bank, 452 Fifth Avenue New York, NY 10018, USA SWIFT (MRMDUS33XXX)

(iii) Sipas Seksionit 3.3 të Kushteve të Përgjithshme të Shitjes, nëse Blerësi nuk na njofton mbi refuzimin e kësaj Oferte Shitjeje brenda 7 Ditësh Pune nga data e marrjes së kësaj Oferte Shitjeje **(Data e Pritshme e Pranimit të Shitjes**),Blerësi do të konsiderohet që ka pranuar Ofertën e Shitjes dhe Marrëveshja e Shitjes do të konsiderohet e përfunduar ndërmjet nesh në Datën e Pritshme të Pranimit të Shitjes.

(iv) Ju lutem tregoni pranimin tuaj të Ofertës së Shitjes me kushtet e paraqitura në këtë dokument duke kundërfirmosur këtë Oferte Shitjeje si më poshtë.

(v) Kjo Marrëveshje, duke përfshirë çdo ndryshim, mund të nënshkruhet në të gjitha kopjet, ku secila prej tyre do të konsiderohet si marrëveshje origjinale dhe të gjitha kopjet përbëjnë një marrëveshje të vetme dhe të njëjtë. Kopjet e kësaj Marrëveshjeje mund të nënshkruhen dhe dërgohen me faksimile apo çdo formë tjetër elektronike (duke përfshirë edhe formatin e një dokumenti portabël) prej secilës palë dhe pala marrëse mund ta konsiderojë marrjen e një dokumenti të tillë të nënshkruar dhe të dërguar në mënyrë elektronike apo me faksimile sikur ka marrë në dorëzim dokumentin origjinal.

Në dëshmi të kësaj, ne kemi nënshkruar dhe dërguar këtë Oferte Shitjeje në datën _/___/____G.

Për dhe në emër të
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

Nënshkrimi/Emri/ Titulli

PRANIMI I SHITJES

I nënshkruari, duke qenë i autorizuar për të nënshkruar dhe dërguar këtë Pranim Shitjeje për dhe në emër të (vendosni shtetin, emrin e marrësit), me anë të kësaj konfirmon pranimin e Ofertës së lartpërmendur të Shitjes dhe jap pëlqimin për blerjen e Aseteve të Projektit nga Banka Islamike për Zhvillim me kushtet e paraqitura më lart në këtë dokument.

Duke nënshkruar këtë Pranim Shitjeje, ne pranojmë që kemi nënshkruar një Marrëveshje Shitjeje me Bankën Islamike për Zhvillim.

Në dëshmi të kësaj, kemi nënshkruar këtë Pranim Shitjeje në datën……G.

Për dhe në emër të
Vendosni Shtetin dhe emrin e marrësit

Emri:
Titulli:
Data: _____/_____/_____/G

FAQJA E NËNSHKRIMIT

NË DËSHMI TË KËSAJ, përfaqësuesit e Palëve të autorizuar posaçërisht kanë nënshkruar këtë Marrëveshje për të amenduar Marrëveshjen Istisna'a (NO ALB-0036/ALB-0107 të datës 02/6/1434H 12/4/2013G) për Shumën e Miratuar që nuk i kalon 56,800,000 USD (Pesëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind mijë) Dollarë Amerikanë në lidhje me financimin shtesë të Shitjes me Këste për Ndërtimin e seksionit Qukës-Qafë Plloçë të Projektit të Korridorit Rrugor Tiranë-Korçë (ALB-1011) në dy kopje në gjuhën angleze në datën e shënuar më lart

Nënshkrimet e Palëve

PËR DHE NË EMËR TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Znj. Delina Ibrahimaj Data:
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

PËR DHE NË EMËR TË
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIMI

Dr. Mohammad Al Jasser
President Data: 04-07-2022

Kodi i Projektit: ALB-1011

MARRËVESHJE NDRYSHUESE E MARRËVESHJES SË AGJENCISË ISTISNA'A
NR. ALB-0036 /ALB-0107 DATË 2/6/1434H (12/4/2013G)

NDËRMJET

KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

FINANCIM SHTESË PËR NDËRTIMIN E SEKSIONIT QUKËS-QAFË PLLOÇË TË PROJEKTIT TË KORRIDORIT RRUGOR TIRANË-KORÇË

(SIPAS SHITJES ME KËSTE)

MARRËVESHJE AGJENCIE

PËR FINANCIMIN ME KËSTE

MARRËVESHJE NDRYSHUESE, datë_05_/_12_/_1443_H e cila i korrespondon/_04_/_07_/_2022_ G
NGA DHE
NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Përfituesi)

DHE
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (BIZH ose Banka),

Secila e referuar si **"Palë"** dhe së bashku si **"Palët"**

DUKE PASUR PARASYSH SE

A. Përfituesi dhe Banka Islamike për Zhvillim nënshkruan Marrëveshjen Istisna'a dhe Marrëveshjen e Agjencisë të lidhur me të më 02/06/1434H (12/4/2013G) (të cilat në vijim referohen si Marrëveshjet Istisna'a) për të financuar Ndërtimin ALB-0036 të seksionit Qukës-Qafë Plloçë të Projektit të Korridorit Rrugor Tiranë-Korçë, siç përcaktohet në Anekset e Marrëveshjes Istisna'a (në vijim të referuara si Asetet e Projektit Istisna'a) për një shumë prej 125,000,000 USD (Njëqind e Njëzet e Pesë Milionë Dollarë Amerikanë). Marrëveshjet Istisna'a hynë në fuqi në datën 19/11/2014G

B. Përfituesi i ka kërkuar Bankës financim shtesë për të blerë asete shtesë që i përkasin Projektit, siç përshkruhen në mënyrë specifike në Skedulin-I të kësaj Marrëveshjeje.

C. Si rrjedhojë, Banka Islamike për Zhvillim ka pranuar kërkesën e Përfituesit dhe në datën 18 dhjetor 2021G miratoi dhe dakordësoi mbi bazën, ndër të tjera, të sa më lart, që të akordojë financim shtesë përmes mënyrës së financimit me këste për të blerë Asetet e Projektit, të cilat janë krijuar nga Asetet e Projektit Istisna'a për një vlerë që nuk kalon shumën prej 56,800,000 USD (pesëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind mijë Dollarë Amerikanë) sipas termave dhe kushteve të parashtruara më poshtë

D. Në bazë të një **Marrëveshjeje Ndryshuese** të lidhur ndërmjet BIZH-it dhe **Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë**, BIZH ka rënë dakord të blejë disa asete që i përkasin Projektit (siç përshkruhet në Skedulin-I të kësaj Marrëveshjeje) dhe **Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë** ka premtuar se do të blejë asetet e projektit nga BIZH;

E. Shuma e aprovuar për prokurimin e Aseteve të Projektit nga BIZH është 56,800,000 USD (Pesëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind mijë dollarë amerikanë)

F. BIZH dëshiron të emërojë Republikën e Shqipërisë si Përfaqësuese për prokurimin e Aseteve të Projektit;

G. Sipas kësaj Marrëveshjeje, marrëdhënia midis BIZH-it dhe Përfaqësuesit është ajo e një *muwakeel* (Porositësit) dhe *wakeel* (të Porositurit) në përputhje me parimet e Shariahut .

SI RRJEDHOJË, Palët bien dakord si më poshtë

Neni 1. **KUSHTET E PËRGJITHSHME; PËRKUFIZIME**

1.1 Kushtet e Përgjithshme

1.1.1 Kjo Marrëveshje i nënshtrohet Botimit të vitit 2020 të Kushteve të Përgjithshme të BIZH-it, të Zbatueshme për Marrëveshjet e Agjencisë **(Kushtet e Përgjithshme**). Kushtet e Përgjithshme përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.1.2 Në rastin e ndonjë mospërputhshmërie midis termave të kësaj Marrëveshjeje dhe Kushteve të Përgjithshme, termat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

1.2 **Përkufizime**

1.2.1 Termat me shkronjë të madhe që nuk janë të përcaktuara këtu do të kenë kuptimin që u atribuohet atyre në Kushtet e Përgjithshme.

Neni 2. AGJENCIA

2.1 Me anë të kësaj Marrëveshjeje, BIZH emëron Përfaqësuesin:

2.1.1 të negociojë dhe të bie dakord me Kontraktuesin për Çmimin e Kontratës dhe të gjitha specifikimet e Aseteve të Projektit;

2.1.2 të lidhë kontratën dhe të mbikëqyrë dorëzimin e Aseteve të Projektit; dhe

2.1.3 të marrë në dorëzim Asetet e Projektit në përputhje me kushtet e Kontratës, Kushtet e Përgjithshme dhe këtë Marrëveshje.

2.2 Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Përfaqësuesi pranon emërimin dhe merr përsipër të kryejë përfaqësimin në përputhje me dispozitat e Kushteve të Përgjithshme dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje për një shumë nominale prej njëqind dollarë amerikanë (100,00 USD).

2.3 Pa cenuar seksionet 2.1 dhe 2.2 të kësaj Marrëveshjeje, BIZH pranon që Përfaqësuesi t'ia delegojë Agjencisë Ekzekutuese përgjegjësitë e tij sipas kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, Përfaqësuesi merr përsipër dhe pranon se do të jetë përgjegjës për çdo veprim ose mosveprim të Agjencisë Ekzekutuese në lidhje me detyrimet e Përfaqësuesit sipas kësaj Marrëveshjeje.

2.4 Për qëllim të Seksionit 2.3, Përfaqësuesi cakton Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) si Agjenci Ekzekutuese.

2.5 Përfaqësuesi do të pranojë financimin e Projektit nga BIZH në materialet e tij me shkrim dhe deklaratat verbale dhe nëpërmjet përdorimit të logos së BIZH-it për Asetet, materialet dhe raportet e Projektit

Neni 3. PROKURIMI

3.1 Përveç rasteve kur BIZH mund të bie dakord ndryshe, Përfaqësuesi do të blejë ose do të mundësojë prokurimin e Aseteve të Projektit në përputhje me Politikat dhe Udhëzimet e Prokurimit të BIZH-it, Seksioni 3 (Prokurimi i Aseteve të Projektit) të Kushteve të Përgjithshme dhe Skedulit II të kësaj Marrëveshjeje (Mënyrat e Prokurimit të Aseteve të Projektit).

3.2 Periudha për përfundimin e prokurimit të Aseteve të Projektit, sipas Kontratës, nuk do të kalojë tre (3) vjet nga data e Disbursimit të parë.

3.3 Specifikimet e Aseteve të Projektit sipas Kontratës do të jenë siç përshkruhen përgjithësisht në Skedulin-I të kësaj Marrëveshjeje dhe të specifikuara në Kontratë.

Neni 4. DISBURSIMI

4.1 BIZH do të kryejë Disbursimet në përputhje me dispozitat e Letrës së Disbursimit dhe në bazë të plotësimit të kushteve të përcaktuara në Seksionet 4.1 (Kërkesat për Disbursim) dhe 4.2 (Kushtet për Disbursim) të Kushteve të Përgjithshme.

4.2 Përveç kushteve të përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme, Disbursimi nga BIZH do t'i nënshtrohet hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Ndryshuese dhe kësaj Marrëveshjeje.

4.3 Afati për paraqitjen e Kërkesës së parë për Disbursim do të jetë 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë nga Data e Hyrjes në fuqi.

4.4 Data e Fundit e Disbursimit do të jetë data e fundit e periudhës së Administrimit.

4.5 Përfaqësuesi do të sigurojë emërimin e një audituesi financiar për Projektin sipas standardeve të pranueshme të Bankës. Kur Përfituesi si Përfaqësues, do të paraqesë një kërkesë për Disbursim, duhet ta shoqërojë me një dokument zyrtar ku konfirmon se është emëruar një audites financiar i pavarur për Projektin. Në rast se audituesi financiar nuk emërohet, kjo do të konsiderohet si Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve dhe do të rezultojë në pezullimin e Shumës së Aprovuar.

Neni 5. PRANIMI ; DORËZIMI

5.1 Përfaqësuesi do të pranojë dhe do të marrë në dorëzim Asetet e Projektit në përputhje me Seksionin 3.6 (Pranimi dhe Dorëzimi i Aseteve të Projektit) të Kushteve të Përgjithshme.

5.2 Në përputhje me Seksionin 3.7 (Njoftimi për Dorëzimin) të Kushteve të Përgjithshme, Përfaqësuesi, jo më vonë se 21 (njëzet e një) ditë nga data e dorëzimit, do t'i japë BIZH-it një Njoftim Dorëzimi kryesisht në formën e Skedulit III të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6. HYRJA NË FUQI

6.1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes Ndryshuese.

Neni 7. KOMUNIKIMI

7.1. Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Përfaqësuesi cakton, vendos emrin e Përfaqësuesit për të vepruar si përfaqësuesi i tij i autorizuar për qëllimet e Seksionit 8.3 të Kushteve të Përgjithshme. Çdo njoftim në lidhje me këtë Marrëveshje do të dërgohet në adresat e mëposhtme të Palëve:

Për Përfituesin:
Ministria e Financave dhe
Ekonomisë
Tel+3554228405
Faks: +_____
Email: sekretariamin@financa.gov.al

Për BIZH-in:
8111 King Khalid St. Al Nuzlah Al Yamania Dist. Unit
No.1 Jeddah-22332-2444,
Kingdom of Saudi
Arabia Tel: +966
12 6361400
Faks: +966 12 6366871
Email: IDBARCHIVES@isdb.org

Neni 8. Kopjet dhe Nënshkrimet

8.1. Kjo Marrëveshje, duke përfshirë çdo ndryshim, mund të ekzekutohet në të gjitha kopjet, ku secila prej tyre do të konsiderohet si marrëveshje origjinale dhe të gjitha kopjet përbëjnë një marrëveshje të vetme dhe të njëjtë. Kopjet e kësaj Marrëveshjeje mund të ekzekutohen dhe dorëzohen me nënshkrim elektronik (duke përfshirë dhe formatin e një dokumenti portabël) nga secili prej Palëve dhe

Pala marrëse mund të bazohet në marrjen e këtij dokumenti të ekzekutuar dhe të dorëzuar elektronikisht njëlloj sikur të ishte marrë dokumenti origjinal.

KJO MARRËVESHJE ka hyrë në fuqi në datën e përcaktuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

Skeduli -I: PËRSHKRIMI I PROJEKTIT, ASETET E PROJEKTIT DHE PLANI I FINANCIMIT

Seksioni I- Përshkrimi i Projektit

Financimi shtesë do të mbulojë kostot (i) punëve të mbetura nga projekti origjinal, (ii) punime shtesë për trajtimet e rrëshqitjeve të tokës të cilat janë të nevojshme për shkak të aktivitetit sizmik të kohëve të fundit, stabiliteti i pjerrësisë dhe argjinaturat, kanalet e fibrave optike, shënjimet rrugore, sinjalistika dhe parmakët e traversave metalike për të rritur sigurinë, (iii) rrugët lidhëse dytësore për të ofruar mundësi më të mëdha hyrjeje, (iv) përforcimi i urave dhe strukturave të tjera për t'i bërë ato më rezistente ndaj aktivitetit sizmik, (v) infrastruktura elektromekanike dhe aparaturat e tuneleve, si dhe (vi) punime të tjera të ndryshme të lidhura.

Një përmbledhje e punëve të mbetura që do të përfundohen sipas Marrëveshjes së Shitjes me Këste, jepet në tabelën e mëposhtme:

#	Aktivitetet Kryesore	Seksioni - 1	Seksioni - 2
1	Punime tokësore (përfshirë gërmime, mbushje, drenazhime anësore etj.)	20%	10%
2	Shtresa asfalti	72%	68%
3	Shenjimet dhe sinjalistika rrugore	100%	100%
4	Mbrojtja dhe stabilizimi i pjerrësive	100%	100%
5	Strukturat (Muret mbajtës, nënkalimet e tubacioneve etj)	17%	25%
6	Urat dhe urë-rrugët	39%	25%
7	Punime elektromekanike në tunele	-	100%

Seksioni II - Asetet e Projektit

Asetet e Projektit në këtë Financim Shtesë Shitjeje me Këste do të përbëhen prej 2 llojesh të punimeve (a) Punime të Nevojshme të Mbetura dhe (b) Punime të Nevojshme për Sigurinë Sizmike, Konektivitetin dhe Sigurinë e autostradave dhe Përmbushjen e Standardeve të paraqitura si më poshtë:

A. Përfundimi i Punimeve të Nevojshme të Mbetura do të kryhet me investimin e 23,709, 034.49 US$

Aktivitetet e mbetura që nevojiten për të përfunduar punimet në vazhdim dhe aktivitetet e mbetura sipas financimit fillestar:

Punime tokësore (duke përfshirë gërmime, mbushje, drenazhim anësor etj.) Shtresat e agregatit dhe betonit në themel
Shtresat e asfaltit dhe shtresa e sipërme

Ndërtimi i strukturave/drenazhimit (mure mbajtës, tubacione anësore etj) Ndërtimi i urave 1,2,3,4 dhe
Zëra të tjerë të tillë si Sistemi Terramesh, Muret Mbajtës, kanalet anësore etj

Detajet e synuara të zërave të punimeve në këtë kategori paraqiten poshtë (të gjitha shumat janë në USD):

Artikuj Pune	Seksioni -1 (2.9 km - 18.0 km)		Seksioni -2 (18.0 km - 133.8 km)		Kostoja totale e përfundimit
	%	Kostoja	%	Kostoja	
Punimet e gërmimit (përfshirë gërmimin, mbushjen, kullimin anësor etj.)	8%	1,153,325.00	18%	1,825,380.77	2,978,705.77
Shtresa bazë agregat	9%	1,196,213.00	4%	403,285.35	1,599,498.35
Baza asfaltike dhe shtresa e sipërme	29%	3,968,859.37	41%	4,049,529.99	8,018,389.36
Strukturat (Muret mbajtëse, tubacionet anësore etj.)	17%	2,381,921.83	21%	2,058,434.49	4,440,356.32
Ndërtimi i Urave 1,4	11%	1,450,000.00	0%	-	1,450,000.00
Ndërtimi i Urave 2,3	17%	2,384,795.00	0%	-	2,384,795.00
Artikuj të tjerë si Terramesh, muri gabion, ulluqe etj, duke përfshirë artikujt e përgjithshëm	9%	1,245,021.14	15%	1,516,874.25	2,761,895.39
Kanal i fijes optike	0%	-	1%	75,394.10	75,394.10
TOTALI		13,780,135.34		9,928,898.95	23,709,034.29

B. Përfundimi i Punimeve të Nevojshme për Sigurinë Sizmike, Lidhshmërinë dhe Sigurinë e autostradës dhe Përmbushjen e Standardeve do të kryhet me investimin prej 22,531,505,96 Dollarë Amerikanë (US$)

Punime të Nevojshme për Sigurinë Sizmike, Sigurinë në autostradë dhe Lidhshmërinë - të nevojshme për të garantuar përputhjen e kombëtare operacionale, të sigurisë dhe sizmike janë	imi i zonave të rrëshqitjes së tokës (Emergjenca e paparashikuar) Mbrojtja dhe stabilizimi i pjerrësisë (Emergjenca e paparashikuar) Përmirësimi i sinjalistikës dhe shenjave rrugore (VO thelbësore) Instalimi i barrierave metalike (mbrojtëse) (Rritja e sigurisë) Ndërtimi i kanaleve të komunikimit me fibra optike (I) Rrugët dytësore (Lehtësimi i aksesueshmërisë Përmirësimi i projektit të urave 1, 2, 3 dhe 4 (Siguria Sizmike) Infrastruktura elektromekanike dhe aparaturat për tunelet S1 dhe S2 (Kërkesë standarde e BE-së) Linja e transmetimit 20 KV

Detajet e synuara për zërat e punimeve në këtë kategori paraqiten më poshtë (të gjitha shumat janë në USD):

#	Artikuj Pune	Seksioni -1 (2.9 km - 18.0 km)		Seksioni -2 (18.0 km - 133.8 km)		Kostoja totale e përfundimit
		%	Kostoja	%	Kostoja	
1	Mbrojtja nga rrëshqitja e tokës dhe shpatet	29%	4,000,000.00	52%	5,182,392.57	9,182,392.57
2	Mobilje rruge, Shenja, Sinjalistika	3%	415,055.50	2%	205,258.50	620,314.00
3	Mbrojtëse të trarëve metalikë (për të përmirësuar sigurinë)	10%	1,440,315.60	22%	2,158,755.00	3,599,070.60
4	Terramesh, mur gabion, ulluqe etj, përfshirë artikujt e përgjithshëm	6%	828,760.00	8%	838,233.33	1,666,993.33
5	Rrugët dytësore (përmirësimi i aksesit)	4%	580,484.51	0%	-	580,484.51
6	Kanali i fibrës optike (përmirëson komunikimin)	3%	467,276.55	0%	-	467,276.55
7	Përmirësimet e urave 5, 6, 7	0%	-	27%	2,637,845.80	2,637,845.80
8	Infrastruktura elektromekanike dhe aparatet e tuneleve	0%	-	35%	3,497,128.60	3,497,128.60
9	Linja e Transmetimit 20 Kv	0%	-	3%	280,000.00	280,000.00
	TOTALI		**7,731,892.16**		**14,799,613.80**	**22,531,505.96**

Seksioni III- Plani i detajuar i financimit të projektit.

Kostoja totale e rishikuar e projektit ALB-0036 dhe ALB-1011, pas përfshirjes së financimit shtesë nga BIZH dhe FSZH (Fondi Saudit për Zhvillim) vlerësohet të jetë 258.55 milionë Dollarë Amerikanë (US$). Financimi shtesë nga BIZH për projektin ALB-1011 është 56.8 milionë Dollarë Amerikanë (US$). Qeveria e Shqipërisë do të paguaje veçmas të gjithë taksat, tatimet dhe TVSH-në që lidhen me Projektin. Detajimi i kostove dhe komponentëve të ndryshëm të Projektit tregohet në tabelën e mëposhtme.

#	Komponentët e Projektit	BIZH			Bashkë Financues-Fondi Saudit për Zhvillim			QSH	Kostoja totale
		Financim i origjinal	Financim i shtesë	Totali	Financim i fillestar	Financim i shtesë	Totali		
1	Blerja e tokës dhe punime të tjera përgatitore	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	2,50	2,50
2	Punime Civile	116,79	46,24	163,03	23,05	43,00	66,05	0,00	229,08
3	Shërbime Konsulence	7,57	3,05	10,62	1,76	1,34	3,10	0,00	13,72
4	Mbështetje për Menaxhimin e Projektit	0,59	0,39	0,98	0,19	0,21	0,40	0,00	1,38
5	Auditimi Financiar	0,05	0,02	0,07	0,00	0,00	0,00	0,00	0,07
Kostoja Bazë Totale		125,00	49,70	174,70	25,00	44,55	69,55	2,50	246,75
Të Paparashikuara		0,00	7,10	7,10	0,00	4,45	4,45	0,25	11,80
Kosto totale		125,00	56,80	181,80	25,00	49,00	74,00	2,75	258,55

Shumat sipas alokimeve aktuale sipas financimit fillestar

Skeduli-II MËNYRA E PROKURIMIT TË ASETEVE TË PROJEKTIT

1. Në këtë Projekt ALB-1011 nuk parashikohet asnjë prokurim i ri; megjithatë, angazhimi i kontraktuesve dhe konsulentëve tashmë të prokuruar dhe NJPMN sipas ALB-0036 do të miratohet sipas rregullimeve të mëposhtme. Për të garantuar një nivel të lartë të angazhimit dhe pajtueshmërisë me kornizat e kontratave të nënshkruara, disa përmirësime/modifikime në dispozitat e kontratave të nënshkruara tashmë do të prezantoheshin dhe do të zbatoheshin në përputhje me rrethanat.

2. **Arsyetimi:** Vijimësia e kontraktuesve dhe konsulentëve të angazhuar aktualisht të punimeve civile nga ALB-0036 për këtë financim shtesë ALB-1011 të Projektit është padyshim zgjidhja më optimale dhe jo prokurimi i ri. Gjithashtu, vazhdimësia e punimeve me kontraktuesit aktualë të angazhuar është konstatuar se është qasja e arsyeshme nga pikëpamja teknike dhe operative. Vijimi i punës, për sa më sipër, me kontraktuesit ekzistues të Seksionit-1 dhe 2 dhe për mbikëqyrjen e punimeve me Konsulentin ekzistues të Mbikëqyrjes dhe vazhdimi i Firmës së Auditimit tashmë të prokuruar duket kryesisht qasja më optimale në aspektin financiar dhe për përmbushjen në kohë dhe me rreziqe minimale të objektivave të Projektit. Si rrjedhojë, kontraktuesit, konsulentët dhe stafi i NJPMN-së tashmë të prokuruar do të vazhdojnë të ofrojnë shërbime në kuadër të këtij Projekti.

3. **Metodologjia:** Kontraktuesit, konsulenti, firma audituese do të angazhoheshin përmes shtesave të kontratës sipas dy kontratave të punimeve civile, kontratës së konsulentit të mbikëqyrjes dhe kontratës së firmës së auditimit.

4. Si rrjedhojë, meqë Projekti është ende në zbatim dhe i paplotë dhe punimet shtesë dhe ato të mbetura janë shtrirja e natyrshme e një qëllimi të mëparshëm ose të vazhdueshëm për të cilin kontratat përkatëse janë dhënë pas procesit të përzgjedhjes konkurruese të ICB-MC-së për kontratat e punimeve civile dhe përzgjedhja nga MC duke përdorur metodën QCBS për kontratën e shërbimeve të konsulencës së mbikëqyrjes, është vendosur që të dorëzohen Urdhrat e Ndryshimit (VO) duke marrë parasysh masat e mundshme zbutëse të dakordësuara në vijim për të garantuar praninë e kontraktuesve në vend, pasi aktualisht, kontraktuesit përfaqësohen plotësisht nga nënkontraktuesit :

a. Përfshirja e një dispozite kundër kufizimit të nënkontraktimit të punimeve në ndryshimet e kontratave të punimeve civile për të mundësuar që kontraktuesit të angazhohen efektivisht në punimet në terren. Në këtë dispozitë do të përcaktohet qartë nënkontraktimi i punimeve që përcakton përqindjen maksimale të punimeve që do të nënkontraktohen nga kontraktuesi kryesor.

b. Meqë kontrata është nënshkruar me "Sintram and Albavia Joint Venture (JV)" për punimet civile të Seksionit-1, Marrëveshja JV e nënshkruar sipas rregullave, do të zyrtarizohet dhe do të merret nga kontraktuesi. Përveç kësaj, do të merren dhe marrëveshjet nën-kontraktuese për të dy seksionet. Në të gjitha këto dokumente, të drejtat dhe përgjegjësitë e secilës palë duhet të përshkruajnë qartë fushën e punës së partnerëve dhe nënkontraktuesve (JV)

c. Pas dorëzimit të draft-projekteve, të cilat pritet të dorëzohen deri në fund të dhjetorit 2021, EA do të garantojë që punimet shtesë do të kostohen brenda financimit shtesë të disponueshëm. Gjithashtu, të dy kontraktuesit do të angazhohen që të ndërtojnë punimet shtesë duke përdorur tarifat e kontratave të punimeve civile pa asnjë rritje. Një marrëveshje e këtij rregullimi duhet të dorëzohet gjithashtu me VO-të.

d. EA dhe Konsulenti i Mbikëqyrjes do të ndjekin nga afër afatet e dakordësuara të planit të zbatimit të projektit.

e. EA do të ndjekë nga afër paraqitjen në kohë të raporteve dy-javore për të përmirësuar cilësinë e performancës së kontraktuesve.

5. Meqë sugjerohet zgjatja e të gjitha kontratave të nënshkruara përmes VO-ve dhe ndryshimet e kontratave për të zbatuar aktivitetet e mbetura në kuadër të projektit, nuk parashikohet asnjë prokurim shtesë sipas

financimit shtesë të propozuar Kontraktuesit, konsulentët dhe stafi i NJPMN-së të punësuar aktualisht do të vazhdojnë të ofrojnë të gjitha shërbimet e kërkuara. Punimet e mbetura, plotësuese dhe përmirësuese, të nevojshme për përfundimin e projektit, do të caktoheshin nëpërmjet dispozitave në fuqi të kontratave tashmë të nënshkruara. Për të garantuar një nivel të lartë të përkushtimit dhe pajtueshmërisë me kornizat e kontratave të nënshkruara, do të nevojiteshin disa përmirësime/modifikime në dispozita dhe do të zbatoheshin në përputhje me rrethanat. BIZH do të rishikojë periodikisht progresin, performancën dhe përputhshmërinë e kontraktuesve me dispozitat e kontratës. Konsulentët dhe stafi i NJPMN-së do të garantonin afatin kohor të gjitha veprimeve dhe progresin sipas planit të punës të miratuar dhe metodologjisë së zbatimit.

6. **Kushtet paraprake të disbursimit:** Kushtet e mëposhtme duhet të plotësohen përpara fillimit të disbursimeve sipas kësaj Marrëveshjeje:

a. Përfundimi, miratimi dhe certifikimi i të gjitha projekteve inxhinierike/përmirësuese të kërkuara për përfundimin e projektit nga ARRSH-ja,

b. Konfirmimi i pranimit nga kontraktuesit dhe konsulentët e tarifave të njësisë sipas kontratave të nënshkruara për kohëzgjatjen e mbetur deri në plotësimin nëpërmjet dokumentacionit ligjor.

c. Konfirmimi dhe paraqitja e Ndryshimit të Kushteve Specifike të Kontratës lidhur me modifikimin e dispozitave të kontratës për:

i. Përqindjen e nënkontraktimit të rënë dakord,

ii. Sigurimin e një marrëveshjeje JV. të ligjshme ndërmjet partnerëve JV

iii. Kontraktuesit (përfshirë të gjithë partnerët JV), të cilët planifikojnë të angazhohen në mënyrë efektive me projektin me role, përgjegjësi, burime të identifikuara qartë, planin financiar/fluksin e parasë JV dhe detajet e nënkontraktimit etj.,

iv. Planin e angazhimit të stafit të konsulentit deri në përfundimin e projektit,

v. Planin e punës të miratuar nga Inxhinieri dhe Punëdhënësi

d. Dorëzimi i të gjitha urdhrave të ndryshimit të nënshkruar dhe projekt-ndryshimeve të kontratave për punimet civile, shërbimet e konsulencës dhe audituesit financiar,

e. Objektivat mujore të disbursimit deri në përfundimin e projektit,

f. Progresi i zbatimit dymujor. Synimet për lehtësimin e mbikëqyrjes nga afër,

g. Dokumentacioni i ARRSH-së që tregon se e gjithë blerja e tokës që kërkohet (përfshirë rrugët dytësore ose linjën e transmetimit etj) ka përfunduar plotësisht dhe zotërimet i janë dorëzuar Projektit.

h. ARRSH-ja dhe NJPMN-ja do të duhet të sigurojnë blerjen e një softueri kontabël të përshtatshëm për Projektin dhe fillimin e menjëhershëm të sistemit të duhur të kontabilitetit për shpenzimet e projektit.

Skeduli-III FORMATI I NJOFTIMIT TË DORËZIMIT

(TË OFROHET NË LETËR ZYRTARE ME STEMË/LOGO)

Banka Islamike për Zhvillim
8111 King Khalid St. Al Nuzlah Al Yamania Dist. Unit No.1 Jeddah-22332-2444,
Kingdom of Saudi Arabia (Mbretëria e Arabisë Saudite)
Tel: +966 126361400
Faks: +966 12 6366871
Email: IDBARCHIVES@isdb.org

Të nderuar,

NJOFTIM DORËZIMI

Ne i referohemi Marrëveshjes së Agjencisë, datë ___/___/____G, të lidhur ndërmjet nesh ("**Marrëveshja e Agjencisë").**

Termat e përcaktuara në Marrëveshjen e Agjencisë (përfshirë Kushtet e Përgjithshme) do të kenë kuptim të njëjtë kur përdoren në këtë Njoftim Dorëzimi.

1. Ky Njoftim Dorëzimi lëshohet në përputhje me Marrëveshjen e Agjencisë dhe i nënshkruari është autorizuar sipas rregullave për të ekzekutuar/nënshkruar dhe dorëzuar këtë Njoftim Dorëzimi në emër të Republikës së Shqipërisë.

2. Me anë të kësaj BIZH njoftohet se Asetet e Projektit na janë dorëzuar nga Kontraktuesi.

3. Ne kemi rishikuar Asetet e Projektit dhe kemi konstatuar se Asetet e Projektit janë në përputhje me specifikimet e përcaktuara në Kontratë dhe Marrëveshjen e Agjencisë dhe si rrjedhojë kemi pranuar Asetet e Projektit.

4. Me lëshimin e këtij Njoftimi Dorëzimi, në konfirmojmë se prokurimi i Aseteve të Projektit ka përfunduar.

Në dëshmi të kësaj, ky Njoftim Dorëzimi është nënshkruar dhe dorëzuar sipas datës të përcaktuar këtu.

Për dhe në emër të
Vendosni Emrin

Emri Titulli i Nënshkruesit

FAQJA E NËNSHKRIMIT

NË DËSHMI TË KËSAJ, përfaqësuesit e Palëve të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje për të ndryshuar Marrëveshjen e Agjencisë (NR. ALB-0036/ALB-0107 të datës 02/6/1434H 12/4/2013G) në lidhje me financimin shtesë të Shitjes me Këste për Ndërtimin e seksionit Qukës-Qafë Plloçë të Projektit të Korridorit Rrugor Tiranë-Korçë (ALB-1011)

Palët	**Nënshkrimet**
PËR DHE NË EMËR **TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË** **Znj. Delina Ibrahimaj** Ministër i Financave dhe Ekonomisë	Data:
PËR DHE NË EMËR TË **BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM** **Dr. Muhammad Al Jasser** President	Data: 04-07-2022